



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 11.03.2015,
e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Naime Osmani (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Qëndron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer .Rusinofci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Besa Rafuna (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK) dhe Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues. Ai tha se pika e tretë - **Propozimrregullorja për kriteret e planifikimit të kushteve të propozuara ndërtimore dhe pika e pestë - Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit Olimpik**, (*ashtu si është propozuar rendi i ditës*), propozoj që të hiqen nga rendi i ditës, të plotësohen edhe më tej dhe të procedohen në njërin nga mbledhjet e radhës.

Lidhur me rendin e ditës diskutuan: Agim Gashi, Ylli Hoxha, Sadri Ramabaja, Sami Hamiti, Dardan Sejdiu, nëkryetar, Flamur Shala, Shemsi Veseli, Islam Pacolli, Hatixhe Pupovci, Kimet Zeqa, Liburn Aliu, Agim Salihu dhe Laura Zherka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Sylejman Pireva propozoi që në rend të ditës të futet për diskutim çështja e ndërtimit të objektit të bibliotekës "Hivzi Sylejmani".

Pas të gjitha diskutimeve lidhur me rendin e ditës, kryesuesi e hodhi në votim propozimin që pika e tretë (3) dhe pika e pestë (5) e rendit të ditës, (ashtu si është propozuar) të shqyrtohen, apo të hiqen nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se, për propozimin që të shqyrtohet pika e tretë dhe pika e pestë (ashtu si janë propozuar), votuan tetëmbëdhjetë (18) anëtarë, (Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha, Qendron Kastrati, Hatixhe Latifi- Pupovci, Teuta Krasniqi, Genc Sherifi, Sylejman Pireva, Sadri Ramabaja, Kreshnik Ahmeti, Bardha Dida -Rogova, Rita Begolli, Imer Rusinovci, Fadil Gashi, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Abetare Fazliu, Visar Arifaj dhe Cuneyd Ustaibo), ndërsa kundër votuan njëzet e gjashtë anëtarë (26), (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra - Ibrhimi, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Besa Rafuna, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi, Shemsi Veseli, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku dhe Remzi Pacolli). Pra, nuk u miratua rendi i ditës ashtu si është propozuar.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash, njëzet e gjashtë (26) për, u miratua propozimi i z. Pireva, që në rend dite të futet për diskutim çështja e ndërtimit të objektit të bibliotekës "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

R E N D D I T E :

- 1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit;**
- 2. Propozimrregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ;**
- 3. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta;**
- 4. Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal "Gërmia" në kategorinë - peizazh i mbrojtur;**
- 5. Diskutim lidhur me ndërtimin e objektit të bibliotekës së qytetit "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë;**
- 6. Propozimvendimi paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës;**

7. Propozimvendimi për lëvizjen e trasesë së rrugës në mes të bllokut "G" dhe "D" në kuadër të Planit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - zona Qendër" afër Pallatit të Drejtësisë;
8. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit mësimor 2014/2015;
9. Informatë për ndarjen e bursave për vitin akademik 2014-2015;
10. Informatë për personelin arsimor në komunë;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit.

Sadri Ramabaja bëri vërejtje në ekstraktin e mbledhjes së parë të Kuvendit, duke thënë se hartimi i ekstraktit është në s'përputhje me Rregulloren e Kuvendit, pasi që nuk janë shënuar emrat e anëtarëve të cilët kanë qenë të pranishëm dhe atyre që nuk kanë qenë të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes, si dhe nuk janë shënuar emrat e anëtarëve të cilët kanë votuar. Vërejte bëri edhe në ekstraktin e mbledhjes së jashtëzakonshme, ku në vend të fjalës "e jashtëzakonshme", është shkruar fjala "urgjente".

Ylli Hoxha bëri vërejtje në ekstrakt, duke u shprehur se ajo mbledhje është mbajtur me dy subjekte politike, me grupin e anëtarëve të LDK-së dhe të PDK-së, pra janë mbledhur bashkë dhe kanë sjellë vendime, por në aspektin procedural nuk e konsiderojmë si seancë të rregullt të Asamblesë, prandaj kërkoj nga të gjithë asamblistët që të mos e legjitimojmë aspak atë proces, të mos e votojmë këtë procesverbal.

Qendron Kastrati bëri vërejte në ekstrakt, duke shprehur mendimin se hartimi i këtij ekstrakti është tendencioz, dhe për këtë kërkoi që të ndërmerret masa.

Muhamet Selmani, vërejtje bëri në ekstrakt, sepse ekstrakti nuk e përshkruan plotësisht atë që ka ndodhur në mbledhje. Është dashtë që të precizohet qartë si është zhvilluar mbledhja, të evidentohen njerëzit që kanë marrë pjesë në mbledhje, njerëzit që e kanë lëshuar mbledhjen, dhe kush ka votuar për dhe kush kundër.

Shefki Gashi theksoi se procesverbali është i incizuar dhe i monitoruar prej mediave dhe organeve të tjera, andaj besoj se ky ekstrakt i plotëson kushtet për miratim.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e tri (23) vota për (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Besa Rafuna, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra- Ibrahim, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Muhamet Selmani, Lirije Avdiu, Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi dhe Shemsi Veseli) dhe njëzet (20) vota kundër (Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha, Qendron Kastrati, Hatixhe Latifi-Pupovci, Teuta Krasniqi, Genc Sherifi, Sylejman Pireva, Sadri Ramabaja, Kreshnik Ahmeti, Bardha Dida - Rogova, Mirlinda Sopi, Rita Begolli, Imer Rusinovci, Fadil Gashi, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviq dhe Cuneyd Ustaibo), me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, u miratuan ekstrakti i procesverbalit të

mbledhjes së jashtëzakonshme dhe ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit.

Pika e dytë

Propozimrregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ.

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se këtë propozimrregullore e kemi diskutuar dhe analizuar në KPF, ku prej secilit grup parlamentar janë trajtuar në detaje vërejtjet që janë dhënë dhe Komiteti për shërbime publike i ka marrë përsipër analizimin e të gjitha këtyre.

Kreshnik Ahmeti, në cilësinë e kryesuesit të Komitetit për shërbime publike, tha se ky komitet ka mbajtur dy takime, në të cilat është diskutuar Rregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ. Në të dy takimet kanë qenë pjesëmarrës edhe përfaqësuesit e bashkësive fetare të Republikës së Kosovës. Në takimin e parë janë ftuar të gjitha bashkësitë dhe janë sugjeruar që t'i dërgojnë komentet e tyre në lidhje me Rregulloren, dhe në mbledhjen e dytë janë ftuar bashkësitë fetare të cilat kanë dërguar komente. Nga ato kanë qenë gjithsej 38 komente, ku jo të gjitha kanë qenë vërejtje për ndryshime në rregullore dhe, së bashku me bashkësitë fetare, i kemi dërguar 15 ndryshime për këtë rregullore. Si anëtar i Kuvendit, propozoi që në nenin 34, të specifikohen qartë përmbajtjet, mesazhet e shenjave dhe simbolet që mund të vendosen në gurët e varreve.

Agim Gashi, në emër të GP të LDK-së, propozoi që titulli i kësaj rregulloreje të jetë:

“Rregullorja për menaxhimin e varrezave të vendbanimeve të komunës së Prishtinës dhe objektit komemorativ”. Po ashtu, akronimi NMV, duhet të zëvendësohet me akronimin SHMV, që nënkupton “Shërbimi për menaxhimin e varrezave”. Vërejtje bëri lidhur me nenet 2, 8, 19, 26, 39 dhe nenin 50, pika 2.

Sylejman Pireva ngriti si shqetësim disa çështje drejtshkrimore, duke thënë se disa terma, shprehje që janë në Rregullore, nuk qëndrojnë. Në vend të fjalës “përdorim” duhet të jetë fjala “shfrytëzim”, si dhe në vend të fjalës “inspektion” duhet të jetë “inspeksion”. Vërejtje bëri edhe në nenet: 9, 11, 17, dhe në nenin 46, pika 1.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se e kemi analizuar këtë projektregullore dhe si Grup parlamentar jemi pak të rezervuar, se mos po i lëndojmë edhe bashkëqytetarët tanë në fshatra, e që janë të komunës së Prishtinës, për arsye se menaxhimi i varrimit bëhet njëjtë si në fshat, ashtu edhe në qytet. I përkrahim vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna si nga GP i LVV-së, po ashtu edhe të GP të LDK-së. Një çështje e cila vlen të diskutohet, që ka të bëjë me harxhimet me rastin e varrimit, konsideroj se rastet sociale është dashur të lirohen nga shpenzimet e varrimit.

Remzi Pacolli, në emër të GP të AKR-së, sugjeroi që të definohet titulli i kësaj rregulloreje, se kështu si është nuk përfshihen edhe varrezat e fshatrave dhe të përcaktohet afati i qëndrimit të kufomës në objektin komemorativ.

Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, me të gjitha ato vërejtje dhe sugjerime që u dhanë nga parafolësit, e përkrahu për miratim propozimrregulloren.

Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, tha se vërejtjet dhe sugjerimet që i kemi për t'i parashtruar, do t'i mbështesim në tekstin që ne sot e kemi para vetes. Vërejtje dhe sugjerime dha në: nenin 5, pika f, nenet 6, 8, 9, 10, pika “c”, nenet 12, 16, 18, 22, 23, 24, 25, pika 3, nenin 27, pika 5,

nenet 29, 34, 35, 36, 45, 48 dhe 59. Me këto plotësime dhe ndryshime, ai u shpreh se do ta përkrahim këtë rregullore për miratim.

Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së, tha se me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që u dhanë, edhe GP i LB-së e përkrah këtë rregullore për menaxhimin e varrezave të qytetit dhe objektit komemorativ.

Visar Arifaj, në emër të subjektit politik PF, u shpreh i pajtimit me vërejtje që u dhanë për nenin 34, por një problem tjetër në këtë rregullore është definimi i termit “komunitet”. Duhet të definohet se a është fjala për fshatin në tërësi, si një komunitet i të gjithë atyre banorëve të fshatit, apo është fjala për komunitet fetar në atë fshat. Nëse është fjala për të gjithë fshatin si komunitet, atëherë le të specifikohet, përndryshe kompetencat të cilat i jepen një komuniteti fetar, duhet të jenë të qartësuara më mirë në marrëdhënie me SHMV-në.

Cuneyd Ustaibo, në emër të subjektit politik KDTP, tha se me të gjitha ndryshimet dhe propozimet e dhëna, këtë rregullore e përkrahim për miratim.

Nenad Miladinovic, në emër të subjektit politik GIS, tha se e përkrahim këtë rregullore për miratim, por gati në secilin nen duhet të futet “*në bashkëpunim me komunitetin fetar*”.

Lidhur me këtë rregullore diskutuan edhe Ylli Hoxha, Naime Osmani, Shaip Hajrizi, Qendron Kastrati, Bardha Dida-Rogova, Sadri Ramabaja, Shefki Gashi, Islam Pacolli dhe Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Duke pasur parasysh diskutimet e parashtruara, kryesuesi tha se obligohet sponsoruesi i kësaj rregulloreje (Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit), që vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna t’i inkorporojë në tekstin final.

Kryesuesi konstatoi se me dyzet e dy (42) vota për dhe një (1) abstenim (Naime Osmani), u miratua Rregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ.

Pika e tretë

Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta.

Për anëtarë të Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta, u propozuan:

1. **Ajnishahe Azemi**, (LDK), kryesuese,
2. **Laura Zherka**, (PDK), anëtare,
3. **Hatixhe Hoxha**, (LVV), anëtare,
4. **Mirlinda Sopi**, (AKR), anëtare dhe
5. **Mexhid Foniqi**, (Shoqata e të Verbërve), anëtar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për themelimin e Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta.

Pika e katërt

Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal “Gërima” në kategorinë - peizazh i mbrojtur.

Lidhur me këtë pikë diskutuan Agimi Salihu, Sami Hamiti, Feti Mehdiu, Dardan Sejdiu dhe Kreshnik Ahmeti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për rikategorizimin e parkut rajonal "Gërima ", në kategorinë - peizazh i mbrojtur.

Pika e pestë

Diskutim lidhur me ndërtimin e objektit të bibliotekës së qytetit "Hivzi Sylejmani " në Prishtinës.

Sylejman Pireva theksoi se ndërtimi i këtij objekti ka filluar më 3 shtator 2010. Përkundër premtimeve nga ish-Kryetari i atëhershëm i Komunës, z. Isa Mustafa, se ky objekt do të përfundojë në një kohë rekord, për një vit, ai nuk është gati dhe nuk është në funksion as sot e kësaj dite. Përkundër konstatimit të shumë defekteve nga ana e komisionit përkatës, është bërë pranimi teknik i këtij objekti, e që konsideroj se organi kompetent i Komunës këtë konkluzion mbi pranimin teknik të këtij objekti, me këso vërejtje relevante të komisionit në fjalë, është dashur ta refuzojë. Është më se e domosdoshme që Komuna të formojë një komision nga ekspertë të zgjedhur, që do ta kryenin një ekspertizë të saktë dhe profesionale, për të konstatuar përgjegjësinë e fajtorit apo fajtorëve, në mënyrë që për të gjitha këto të kërkohet llogaridhënie dhe përgjegjësisë, e që janë të ndërlidhura me çështjen e ngritur nga Grupi i asamblistëve të LVV-së.

Për këtë temë diskutuan edhe Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Qendron Kastrati dhe Abit Kastrati, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve për këtë pikë, nxirret ky konkluzion:

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që ta përgatit një raport rreth punës së komisionit për pranimin teknik të këtij objekti, dhe në mbledhjen e radhës ta njoftojë Kuvendin.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës.

Lidhur me këtë propozimvendim, të pranishmit i njoftoi **Agim Salihu**. Ai tha se ky propozimvendim dhe i tërë dokumentacioni i palës, duhet t'i adresohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për pëlqim, pastaj varësisht nga veprimi që merr Ministria, duhet të veprojë Kuvendi i Komunës.

Kryesuesi theksoi se pa u marrë pëlqimi prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nuk mund të marrim vendim për destinim të tokës.

Për këtë propozimvendim diskutuan edhe Sami Hamiti, Shefki Gashi dhe Shiqeri Spahiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash, tridhjetë e shtatë (37) vota për, dhe një (1) abstenim (kryesuesi), u miratua Vendimi paraparak për ndërrimin e destinimit të tokës.

Pika e shtatë

Lidhur me këtë propozimvendim, arsyetimin për lëvizjen e trasesë së rrugës e paraqiti Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Njëzëri u miratua Vendimi për lëvizjen e trasesë së rrugës në mes të bllokut "G" dhe "D", në kuadër të Planit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - zona Qendër" afër Pallatit të Drejtësisë.

Pika e tetë

Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit mësimor 2014/2015.

Lidhur me Informatën për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit mësimor 2014/2015, të pranishmit i informoi Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Ajo theksoi se kjo informatë ka të bëjë me suksesin e arritur të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2014/2015. Analiza e suksesit është për të tri nivelet, duke filluar prej shkollimit fillor, shkollimit të mesëm të ulët dhe shkollimit të mesëm të lartë. Këto janë rezultatet e bazuara në vlerësimin që e kanë bërë mësimdhënësit nëpër klasat e tyre.

Qëllimi i kësaj analize është që jo vetëm të konstatohet një gjendje faktike, por edhe bazuar në këtë, janë planifikuar edhe aktivitetet dhe punët, si dhe objektivat e Drejtorisë së Arsimit për vitin 2015/2016.

Lidhur me informatën diskutuan: Flamur Shala, Ylli Hoxha, Lirjeta Rexhepi, Sofije Bunjaku, Feti Mehdiu, Abetare Fazliu, Visar Arifaj, Cyneid Ustaibo, Shefki Gashi, Sadri Ramabaja, Teuta Krasniqi, Mirlinda Sopi, Abit Kastrati, Hatixhe Hoxha, Kreshnik Ahmeti, Hatixhe Pupovci, Vjollca Dibra - Ibrahim, Sokol Krasniqi, Islam Pacolli, Sylejman Pireva, Lirije Avdiu dhe Ajnishahe Azemi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se, me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit mësimor 2014/2015.

Pika e nëntë

Informatë për ndarjen e bursave për vitin akademik 2014-2015.

Lidhur me Informatën për ndarjen e bursave për vitin akademik 2014-2015, të pranishmit i njoftoi Arbërie Nagavci, drejtoreshë e DA-së. Ajo tha se ndarja e bursave nuk është bërë në mënyrë uniforme për të gjithë. Kriteret e përgjithshme kanë qenë që të gjithë ata që kanë aplikuar, të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa, të mos jenë shfrytëzues të një burse tjetër, të mos jenë të punësuar, të mos jenë përsëritës të vitit akademik, si dhe të paraqesin dëshmi për gjendjen sociale - ekonomike për gjendjen e familjes. Lidhur me këtë, prezantoi edhe listën me numrin e përfituesve të bursave për fakultetet përkatëse.

Për këtë pikë diskutuan edhe Feti Mehdiu, Lirijeta Rexhepi, Sadri Ramabaja, Qëndron Kastrati, Flamur Shala dhe Teuta Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për ndarjen e bursave për vitin akademik 2014/2015.

Pika e dhjetë
Informatë për personelin arsimor në komunë.

Lidhur me **Informatën për personelin arsimor në komunë**, të pranishmit i informoi **Arbërie Nagavci**, drejtoreshë e DA-së, e cila tha se sa i përket përzgjedhjes, apo rekrutimit të stafit për krijimin e standardit të punësimit në institucionet arsimore në vitin 2014, kemi nxjerr disa vendime të rëndësishme, si vendimi për procedurën e përzgjedhjes së mësimdhënësve, ku përshkruhet saktësisht procedura e përzgjedhjes së stafit nga ana e mësimdhënësve, pastaj vendimin për kriteret e paraseleksionimit, dhe vendimin për angazhimin e stafit edukativo arsimor në raste të paparashikuara, duke u mbështetur në ligjet dhe udhëzimet administrative të Republikës së Kosovës.

Për këtë pikë diskutuan edhe Flamur Shala, Ylli Hoxha dhe Sadri Ramabaja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për personelin arsimor në komunë.

Pika e njëmbëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje

Islam Pacolli, kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.

Banorët e fshatit Golimivadë, kanë bërë kërkesë për asfaltimin e një rruge, në gjatësi prej katër (4) km.

Shiqeri Spahiu tha se nga dhjetori i vitit të kaluar kam parashtruar dy kërkesa dhe nuk kam marrë përgjigje.

Sipas informatave që kemi, Qendra Rekreative Kulturore në Gërmi e ka ndërruar destinimin, qendër e cila ka qenë në menaxhimin e ndërmarrjes "Sport Marketing", dhe nga "Sport Marketingu" i është dhënë ndërmarrjes publike "Hortikultura". Në vitin 2013, është marr një vendim në Kuvend, që kjo qendër i është dhënë për dhjetë vjet në shfrytëzim të përkohshëm ndërmarrjes "Sport Marketing".

- Me çfarë vendimi është bërë ky ndryshim, ndërrimi i destinimit, dhe nëse është bërë, kush e ka dhënë këtë urdhër dhe mbi çfarë baze?

Sylejman Pireva parashtrroi këtë pyetje:

- Çfarë qëndrimi do të mbajë kjo qeveri komunale lidhur me pompat e benzinës nëpër lagje të Prishtinës, ku nuk e kanë vendin?

Sokol Krasniqi, pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

- Komuniteti i lagjeve "Arbëria 3" dhe "Sofalia", kanë kërkuar të marrin informacionin se, pasi që planet rregulluese në këto dy lagje kanë kaluar leximin e parë dhe janë bërë diskutimet publike në nëntor – dhjetorë, pse nuk janë proceduar për miratim në Kuvendin e Komunës për leximin e dytë dhe procedimin e mëtutjeshëm?

Shaip Hajrizi, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

- Cilat rrugë janë të parapara për realizim gjatë këtij viti në lagjen "Kodra e Trimave"?
- A do të merret ndonjë iniciativë për ndriçimin e rrugëve në lagjen "Kodra e Trimave"?
- Pse rrugët e komunës së Prishtinës nuk pastrohen kur bie borë? Kemi fshatra që janë të bllokuara, si Koliqi, Prapashtica, Keçekolla, ku asnjë metër e rrugëve nuk është pastruar.

Lirijeta Rexhepi, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Kërkoj nga kjo drejtori që të punohet më tepër në ndriçimin e rrugëve, e në veçanti të bëhet ndriçimi te Biblioteka Kombëtare.

Përsëri kërkoj që të bëhet ndriçimi i rrugëve edhe nëpër pjesët rurale të komunës sonë, e në veçanti në fshatin Tenezhdoll.

Pyetje për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me objektet dhe monumentet e trashëgimisë kulturore në komunë të Prishtinës.

Kërkoj raport se a është ndërmarrë diçka konkrete nga Komuna për t'i mbrojtur dhe shfrytëzuar këto resurse që i posedon Komuna e Prishtinës. Rast konkret do të ishte Kalaja e Kulinës, që i përket kohës së Parahistorisë, që është identifikuar para tridhjetë viteve dhe më nuk është ndërmarrë asgjë në atë drejtim.

- Cilat janë kompetencat e Komunës në këtë drejtim dhe cili është plani apo strategjia në të ardhmen për këto objekte?

Muhamet Selmani, pyetje për Zyrën e prokurimit, Drejtorinë e Administratës dhe Drejtorinë e Arsimit.

Kërkoj që t'i kemi në dispozicion kopjet e kontratave të furnizimit me derivate për Komunën e Prishtinës, nga 1 shtatori 2014 deri në mars 2015, të gjitha, duke përfshirë kontratat me kompanitë që e kanë bërë furnizimin dhe çmimet e naftës.

Kërkoj të kemi informacionin lidhur me mënyrën e furnizimit me ushqim të çerdheve të Komunës së Prishtinës, nga 1 shkurti 2015 e deri më sot, si janë furnizuar, kush i ka furnizuar dhe nga është marr ushqimi që u servohet fëmijëve, sepse kontrata për Komunën ka skaduar më 1 shkurt të këtij viti.

- Çfarë masash janë ndërmarrë lidhur me rastin e ndodhur rreth furnizimit me kifile në shkollën e fshatit Keçekollë, dhe furnizuesi nga e ka marr miellin që i ka përgatitur ato kifile që ua ka servuar fëmijëve?

- A ka ndërmarrë Komuna e Prishtinës ndonjë masë apo kontroll për furnizuesit e kifileve, nga furnizohen me miell, kur e dimë se është një aferë e madhe e miellit në komunën e Prishtinës?

Teuta Krasniqi, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.

Në lagjen "Velania", një rrugë me gjatësi prej 100 m, e cila është e shtruar me kubze, rrugë e cila është prishur thuajse krejt, në të dy anët e rrugës, dy shtëpi që janë, i kanë qitur disa shkallë në rrugë, edhe në anën tjetër është një muri gati duke u rrezuar, objekte të cilat paraqesin rrezik për qytetarë. Kërkoj të dijë se a është në projekt rregullimi i kësaj rruge.

Po ashtu, banorët e kësaj lagje janë të brengosur shumë për mosekzistimin e një linje të trafikut urban për transportin e qytetarëve.

Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Banorët e fshatit Rimanishtë, më konkretisht, disa shtëpi në Lagjen e Mramorëve, kërkojnë rregullimin e rrugës Rimanishtë - Sharban, gjegjësisht deri te përmendorja.

Po ashtu, ndërtimin e rrugës e kanë kërkuar edhe banorët e Lagjes Rexhaj, si dhe ndërtimin e rrugës Siqevë - Rimanishtë, rrugë e cila shpie për në lagjen "Staraplegjë".

Kërkoj po ashtu që në fshatin Besi (kërkesë e cila është parashtruar edhe më herët), të bëhet ndriçimi i rrugës, sidomos në Lagjen e Bllacajve, ku fëmijët janë të rrezikuar nga qentë endacakë.

Abit Kastrati tha se, sipas informatave që kemi, jemi të njoftuar se në Tregun e Gjelbër, Komuna ka hequr dorë prej parcelave të veta, sepse i ka disa të vetat dhe i ka disa të ish-Fabrikës së Amortizatorëve dhe ia ka dhënë AKP-ës. Lidhur me këtë, kërkoj një informatë nga organet kompetente të Komunës, se çka është duke ndodhur me Tregun e Gjelbër.

Hatixhe Latifi-Pupovci: Sugjeroj organet kompetente të Komunës, që të gjitha projektet të cilat janë të parapara për vitin 2015, të qiten në web-faqe, për arsye që të mos ketë nevojë askush të pyes se çka është e paraparë, cila rrugë, cili vend është i paraparë që të intervenohet. Nëse janë në web-faqe të Komunës, atëherë jemi të njoftuar të gjithë lidhur me atë se çka po ndodh brenda Komunës.

Pika e dymbëdhjetë

Të ndryshme

Kimet Zeqa tha se në dhjetor të vitit të kaluar, është votuar për ndryshimin e rendit të ditës, që pika - Pyetje dhe përgjigje, të jetë pika e parë e rendit të ditës dhe deri më sot nuk është ndryshuar. Kërkoj që të ndërmerren masa për ndryshimin e rendit të ditës.

Po ashtu, kërkoj nga kryesuesi që të njoftohen anëtarët e Kuvendit, të cilët janë ftuar në një trajnim lidhur me menaxhimin e buxhetit, i cili do të mbahet në Bogë.

Mbledhja mbaroi në orën 17:35.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.